



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 6

30 janar

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim plotësues i MF nr. 3, datë 17.1.2014	Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014.....	105
Udhëzim i MF nr. 4, datë 25.1.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.....	138
Vendim i ERE nr. 1, datë 17.1.2014	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	142
Vendim i ERE nr. 2, datë 17.1.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	142
Vendim i ERE nr. 3, datë 17.1.2014	Për licencimin e shoqërisë “En. Ergy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	143
Vendim i ERE nr. 4, datë 17.1.2014	Mbi modifikimin e licencës me nr. 17, seria PV04P të shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC “Bene”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 43, datë 14.10.2004.....	144
Vendim i ERE nr. 5, datë 17.1.2014	Mbi ankandin e muajit shkurt 2014 të kapaciteteve të interkonjeksionit.....	145

UDHËZIM PLOTËSUES
Nr. 3, datë 17.1.2014

PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2014

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 19 të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014” dhe në vijim të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2, ministri i Financave

UDHËZON:

I. PROCEDURA SPECIFIKE SHITESË PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHITESIT

Të përgjithshme

1. Për çdo njësi shpenzuese të krijuar rishtazi, çelet kodi përkatës në sistemin informatik financiar të qeverisë, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, e shoqëruar detyrimisht me aktin përkatës ligjor ose nënligjor apo akte të tjera administrative të krijuarit të tij. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e mbylljes së një njësie shpenzuese.

Detajimi i disa fondeve buxhetore

2. Fondi i planifikuar për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, në artikullin 604, detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor paraqet te nëpunësi i parë autorizues, struktura përgjegjëse për buxhetin, detajimin sipas strukturave buxhetore të miratuara. Fondet për spitalet bëhen të disponueshme në kapitullin 08 (burimi i fondit buxhetor).

3. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve janë planifikuar fondet për investime për arsimin universitar edhe në formën e fondeve për zhvillimin e rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë do të përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes së projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilat miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë mund të bashkëfinancojnë për objekte investimesh edhe nga të ardhurat e veta.

4. Zbatimi i vendimeve gjyqësore që lidhen me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe rikthimi i vlerave të arkëtuara, subjekteve që u është ndërprerë procesi i legalizimit në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin e integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, do të përballohen me të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë e kompensimit të pronave.

5. Investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore çelen në strukturën: Ministria e linjës 00, program xxxxx, kapitull 05, të specifikuar me kode projekti. Shkresat e çeljes së këtyre fondeve do të hidhen në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtën e ndryshimit të emërimit të projekteve.

6. Detajimi i fondeve për investime të miratuara në ligjin e buxhetit për vitin 2014, si dhe kërkesat për rishpërndarje apo për fonde shtesë për investime, do të paraqiten pranë nëpunësit të parë autorizues nga nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes qendrore, pasi të jetë marrë konfirmimi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Ministrinë dhe institucionet qendrore, në detajimin e planeve të miratuara të investimeve, do të mbajnë parasysh këto kritere:

- Projektet e investimeve të propozuara për financim duhet të jenë pjesë e projekteve të propozuara dhe të shqyrtuara në Kuvend deri në datën e miratimit nga Kuvendi të ligjit të buxhetit për vitin 2014;

- Financimi i projekteve në vazhdim nga viti 2013 ose më parë duhet të jetë pjesë e prioriteteve;



- Financimi i detyrimeve lokale për TVSH-në, taksa doganore ose bashkëfinancimet nga buxheti i shtetit për projektet me financim të huaj do të bëhet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar;

- Projektet e miratuara në kuadër të PBA 2014-2016, sipas prioriteteve sektoriale të propozuara nga ministritë dhe institucionet qendrore;

- Projektet e reja të propozuara për financim në kuadër të buxhetit për vitin 2014 do të shoqërohen me formularët e projekteve dhe relacionin përkatës;

- Projekte të reja të papërfshira në sa më sipër do të financohen vetëm në kushtet e emergjencës dhe të shoqëruara me një relacion të hollësishëm për domosdoshmërinë e investimit të kërkuar dhe pas miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes (MZHETS).

Nëse në listën e projekteve të detajuara nga ministritë dhe institucionet qendrore ka projekte të reja që nuk kanë qenë të përfshira në buxhetin vjetor të miratuar nga Kuvendi, MZHETS-ja merr në konsideratë financimin e këtij projekti vetëm nëse është miratuar në kuadër të PBA 2014-2016 dhe nëse ka kaluar të gjitha fazat procedurale të parashikuara në udhëzimin “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të rishikuar. Projektet që plotësojnë kushtet e mësipërme, dhe me vlerë deri në 50 milionë lekë, do të financohen vetëm pas miratimit paraprak të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes. Projektet me vlerë mbi 50 milionë lekë do të financohen vetëm pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin Ndërmintor për Zhvillimin Ekonomik. Nëse projekti i propozuar nuk ka qenë pjesë e PBA 2014-2016 dhe nëse nuk plotëson asnjë nga kushtet e mësipërme, kërkesa për financim do të bëhet vetëm në kuadër të rishikimit të buxhetit vjetor. Nëse në listën e detajuar të projekteve të investimeve nga njësitë e qeverisjes qendrore, listohen projekte që paraqesin kontrata të punimeve shtesë, çelja e tyre do të bëhet nga ministri i Financave, bazuar në relacionin mbi domosdoshmërinë e tyre dhe me miratim paraprak të ministrit të Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin e rialokimeve të projekteve të investimeve gjatë zbatimit të buxhetit.

7. Fondet për projekte të reja të investimeve dhe blerjen e pajisjeve elektronike, të cilat nuk e kanë ndjekur ciklin e planifikimit të investimeve publike dhe që lidhen me teknologjinë e informacionit, bëhen efektive pas konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Në rastet kur në marrëveshjen dypalëshe, të nënshkruar për zbatimin e projekteve me financim të huaj, është përcaktuar që disbursimi nga donatori/kreditori do të bëhet pasi të jetë kryer shpenzimi dhe pasi të jetë vlerësuar performanca e projektit, atëherë për kryerjen e shpenzimit, ministritë/institucionet, në rast se nuk kanë parashikuar fondet përkatëse në planin e buxhetit vjetor, do të shqyrtojnë mundësinë e një rialokimi për të siguruar fondet e nevojshme. Fondet e rimbursuara nga financuesi sipas projekteve përkatëse, do të regjistrohen në një zë të veçantë për t’u dalluar nga grantet dhe kreditë e tjera, me emërtimin “Rimbursim i shpenzimeve pas vlerësimit të performancës”.

8. Në mbështetje të nenit 10 të ligjit 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, detyrimet e prapambetura dhe fondi i kompensimeve shpërndahen sipas ministrive përkatëse, sipas rregullave, procedurave dhe kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave.

Numri i punonjësve buxhetorë dhe shpenzimet e personelit

9. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror detajohet nga ministritë dhe institucionet qendrore në përputhje me emërtesën e institucionit dhe numrit përkatës të saj të përcaktuar në urdhrin e miratimit të strukturës së çdo institucioni varësie. Si rregull, ky numër i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1 shkurt 2014, ndërsa në muajin janar, për pagesat e punonjësve do të operohet me numrin e punonjësve të muajit dhjetor. Të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore depozitojnë deri në datën 17 shkurt, në Ministrinë e Financave, urdhrat e miratimit të strukturave për çdo institucion varësie.

10. Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014, për vitin 2014 nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogarit, sipas gradave të miratuara. Përfshirje bëjnë institucionet e reja të krijuara gjatë vitit buxhetor.

11. Efektet financiare të ndryshimit të strukturave të njësive të qeverisjes qendrore përllogariten dhe vlerësohen nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave.

12. Pagesat e listës së pritjes do të bëhen me bordero të veçantë. Paga e personit në listëpritje do të kalojë në shpenzime, në llogarinë ekonomike “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, të emërtuar art. 606, ndërsa sigurimi shoqëror shëndetësor do të kalojë si shpenzime në llogarinë e emërtuar art. 601. Institucionet që nuk kanë të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, shpenzime në art. 606, do të kërkojnë transferimin e këtyre fondeve nga shpenzimet korrente të miratuara. Edhe pagesa që lidhet me shpërblimin e parashikuar në Kodin e Punës për largimin nga puna për shkak të ristrukturimit për punonjësit, do të kalojë si shpenzim në llogarinë ekonomike “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, të emërtuar art. 606.

13. Numri rezervë i punonjësve përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit dhe alokohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e detajimit dhe të miratimit përcaktohen në të njëjtën mënyrë si për punonjësit organikë.

14. Punonjësit me kontratë të përkohshme pune, mbi numrin organik të miratuar, krahas atyre të miratuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, konsiderohen edhe instruktorët e qendrave të formimit profesional të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe anketuesit e Institutit të Statistikave.

a) Për instruktorët e qendrave të formimit profesional, hartohet udhëzimi vjetor i përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe më pas bëhet autorizimi i pagesave për këta punonjës.

b) Për anketuesit e INSTAT-it, detajimi i punonjësve për çdo rreth, afati kohor, emërtesa dhe niveli i pagës bëhen nga vetë INSTAT-i, sipas udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 24.3.2010.

15. Çdo ndryshim i numrit të punonjësve nga një njësi shpenzuese te tjetra, shoqërohet detyrimisht me aktin përkatës të strukturës së miratuar të njësive shpenzuese. Përfshirje nga ky rregull, veprohet:

a) Për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe gjykatave, për transferimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve nga një njësi shpenzuese në një tjetër, miratimi i ndryshimit të numrit të punonjësve organikë, bëhet pas vlerësimit të koston financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit të shoqëruar me urdhrin përkatës të emërimit të prokurorit/gjyqtarit.

b) Çdo transferim i numrit të punonjësve mësimorë organikë nga një shkollë në tjetrën, bëhet pas vlerësimit të koston financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit qendror.

16. Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore përdoret nga çdo njësi shpenzuese për numrin faktik mujor të punonjësve në organikë, brenda numrit limit të miratuar. Nuk lejohet përdorimi i fondit të lirë që rezulton nga strukturat e paplotësuara apo nga reduktimi i strukturave aktuale dhe vetëm në raste specifike, përdorimi i këtij fondi miratohet nga Ministria e Financave. Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore përdoret për pagesën e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, kur është parashikuar një fond i tillë nga Ministria e Financave.

17. Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahen në konsideratë rregullat e përcaktuara në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

18. Plotësimi i bordersë së pagave të bëhet sipas shtojcës nr. 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi.



Fondi i veçantë

19. Fondi i veçantë i njësive shpenzuese nuk është pjesë e fondit të pagave, pasi ky fond do të alokohet dhe do të përdoret me miratim të ministrit të Financave.

20. Limiti maksimal i fondit të veçantë, i parashikuar për t'u përdorur për çdo njësi të qeverisjes qendrore, është përcaktuar në tabelën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Njësitë e qeverisjes qendrore njoftojnë të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë për limitin maksimal të fondit të veçantë për t'u shpenzuar prej tyre. Përdorimi i fondit të veçantë bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar.

21. Kërkesat për përdorimin e fondit të veçantë, brenda limitit të njoftuar, do të paraqiten rast pas rasti nga njësitë e qeverisjes qendrore te nëpunësi i parë autorizues, i cili i shqyrton nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe i propozon për miratim te ministri i Financave. Kjo kërkesë duhet të përmbajë edhe informacionin lidhur me shumën e përdorur nga fondi i veçantë deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë.

22. Në fondin limit të përcaktuar sipas pikës 20, nuk përfshihet fondi i veçantë i njësive të qeverisjes vendore, i fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondit të sigurimeve shëndetësore, i universiteteve dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për Bashkitë dhe Komunitat dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit për Bashkitë dhe Komunitat. Për këto institucione, kërkesa për përdorim nga fondi i veçantë me destinacion të përcaktuar në shkresë, paraqitet nga njësia shpenzuese në degën e thesarit, duke respektuar kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010, të ndryshuar. Në rast të përdorimit, ai transferohet nga vetë njësitë nga artikulli 600 në artikujt 602 dhe 606, sipas natyrës së shpenzimit. Një kopje e kësaj kërkesë paraqitet nga dega e thesarit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit për t'u regjistruar në sistemin informatik financiar të qeverisë.

Kontrolle financiare paraprake shtesë në procesin e menaxhimit të fondeve publike

23. Për qëllime të një menaxhimi financiar eficient të fondeve publike dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të papaguara në kohë, çdo njësi e qeverisjes qendrore depoziton regjistrin e prokurimeve publike zyrtarisht dhe elektronikisht në degën e thesarit në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo ndryshim të tij gjatë vitit, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve duhet të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor.

24. Në rast se parashikohen prokurime për kontrata shumëvjeçare, ato duhet të paraqiten në regjistër, duke specifikuar veçmas fondin e nevojshëm për vitin buxhetor 2014 dhe fondet e parashikuara për secilin vit buxhetor, deri në plotësimin e shërbimeve/punimeve të planifikuara.

25. Dega e thesarit kryen kontrollin e totalit të fondeve të paraqitura në regjistrin e prokurimeve me totalin e fondeve të miratuara në buxhetin e njësisë dhe vetëm pasi vulozet nga Thesari, njësia mund ta dërgojë në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

26. Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, regjistrojnë në sistem çdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e thesarit, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

27. Të gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet, duhet të paraqiten në degën e thesarit së bashku me ftesën për prokurim, të cilat duhet: i) t'i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në thesar; ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulozen nga dega e thesarit të rrethit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik.

28. Deri në përcaktimin e limiteve të angazhimeve trevjeçare, me vendim të Këshillit të Ministrave, do të procedohet vetëm me miratimin e urdhrave njëvjeçarë të prokurimit.

29. Në zbatim të detyrimit sipas pikave të mësipërme, dega e thesarit krijon bazën e të dhënave jashtë SIFQ-së, duke regjistruar për çdo institucion, kundrejt buxhetit të miratuar, çdo

projekt investimesh dhe çdo prokurim mallrash dhe shërbimesh me vlerë mbi 30 milionë lekë, vlerën totale sipas planit të prokurimit dhe në rastin e prokurimeve shumëvjeçare, regjistrojnë edhe shpërndarjen e shumës së tyre në vite.

30. Dega e thesarit informon strukturën përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave, një herë në muaj, brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës, mbi urdhrat e prokurimit të miratuar prej saj sipas pikës 29 të këtij udhëzimi dhe sipas strukturës buxhetore. Njëkohësisht dërgon informacion të detajuar të nëpunësi i parë autorizues për prokurimet e shërbimeve me vlerë 30 milionë lekë e lart dhe për investimet.

31. Nëse në degën e thesarit paraqitet një urdhër prokurimi i pambuluar me fonde buxhetore, atëherë dega e thesarit refuzon me shkrim dokumentin e paraqitur dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik. Në asnjë rast, APP-ja nuk fillon procedurën zyrtare të prokurimit, pa pasur më parë një miratim të degës përkatëse të thesarit.

32. Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të paraqiten dhe të procedohen në degën e thesarit të rrethit sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e thesarit procedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë nëpunësin e parë autorizues, i cili ndërmerr masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimin e kryer.

33. Nëpunësi i parë autorizues, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin, monitoron në mënyrë të veçantë ecurinë e përdorimit të fondeve buxhetore për vlerat e shërbimeve/punimeve shumëvjeçare.

34. Ministria e Financave do të zhvillojë një sondazh çdo tre muaj te ministrinë kryesore, nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2014 dhe do të zhvillojë një analizë të periudhës së pretendimeve, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe duke vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Menaxhimi i likuiditetit

35. Njësia qendrore e përgjithshme paraqet urdhërshpenzimin, duke përcaktuar qartë datën e pagesës së faturës sipas kontratës. Në SIFQ regjistrohet data e faturës së furnitorit, data e urdhërshpenzimit të përgatitur dhe të paraqitur në thesar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, data e regjistrimit të urdhërshpenzimit në SIFQ, si dhe data në të cilën duhet të kryhet pagesa për faturën respektive, e cila duhet të jetë në përputhje me kushtet e kontratës. Ky rregull zbatohet edhe nga institucionet buxhetore që kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ.

Transaksionet në valutë të huaj

36. Gjatë procesit të menaxhimit të shpenzimeve të projekteve me financim të huaj, që administrohen me skemë të pjesshme thesari, transfertat nga llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë në llogaritë bankare të projekteve me financim të huaj, kryhen në monedhën shqiptare nga struktura qendrore përgjegjëse për thesarin, përveç kontratave të lidhura në valutë të huaj sipas paragrafit 145 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012.

Llogaritë speciale

Llogaria speciale e të përndjekurve politikë

37. Nëpunësi autorizues i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të përdorë fondet e planifikuara për të përndjekurit politikë në grupin 25, në masën dhe sipas listëpagesave të miratuara nga NPA-ja.

38. Në udhëzimin nr. 9, datë 11.4.2012 “Për procedurat e përllogaritjeve dhe pagesave të dëmshpërblimeve për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, pika 14 dhe 15 bashkohen dhe ndryshojnë si më poshtë: struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave harton listëpagesën dhe mbi bazën e tyre përpilon përmbledhësen për çdo bankë. Përmbledhësja totale e pagesave e detajuar për çdo bankë të nivelit të dytë i dërgohet nëpunësit autorizues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale



dhe Rinisë, për procedimin e pagesës në llogaritë e bankave të nivelit të dytë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë.

39. Në prioritetet e pagesave sipas pikës 139 të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, të konsiderohet prioritet “transaksioni i pagesës për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve”, në renditje direkt pas pagesës “ndihmë ekonomike”.

40. Llogaria speciale e shpronësimeve. Gjendja që ka mbetur në llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë e Qeverisë” në Bankën e Shqipërisë, do të përdoret me paraqitjen e listës së përfituesve, në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave përkatëse të angazhuara.

Të ardhurat jashtë limitit

41. Në të ardhurat jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e procedurave standarde të zbatimit të buxhetit, përfshihen edhe të hyrat e mëposhtme:

- a) Të hyrat që mblidhen nga zyrat e përmbarimit për llogari të të tretëve;
- b) Të ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga lotosporti ose nga sponsorizimet e tjera;
- c) Fondet e akorduara nga Kompania Energjetike Shqiptare për përballimin e dëmeve nga përmbytjet;
- d) Të ardhurat nga organizmat e vlerësimit të konformitetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, që përdoren për pagesën e vlerësuesve të kontraktuar nga kjo drejtori në zbatim të ligjit nr. 9824, datë 1.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1716, datë 3.10.2008 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” dhe standardit SSH ISO 17011:2005 që rregullon veprimtarinë e organizmave akreditues;
- e) Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje “Për transferimin e parcelës ndërtimore”, sipas aktrakordimit midis zyrës qendrore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritetit të Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe strukturave përgjegjëse për thesarin në degë, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë speciale të fondit të kompensimit të pronave, pranë Bankës së Shqipërisë;
- f) Të ardhurat nga Parku Kombëtar i Butrintit;
- g) Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, Inspektoratit Qendror Teknik, Institutit të Ndërtimit, Universitetit të Tiranës dhe strukturës përgjegjëse për doganat shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë.
- h) Të ardhurat e realizuara nga shitja e mallrave rezervë shtetërore gjatë procesit të freskimit të mallrave rezervë dhe që përdoren për zëvendësimin e mallrave të shitura;
- i) Të ardhurat gjendje prej 15 127 500 lekësh, të mbledhura nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit të vitit 2006, të cilat në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 868, datë 27.10.2010, përdoren për shpenzimet që nevojiten për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondet kundërparti dhe “*Non Project Grand Aid*”;
- j) Të ardhurat nga INSIG-u për pagesat që do të kryhen për rastet e dëmtimit të mjeteve të siguruara;
- k) Të ardhurat e realizuara nga pagesat e kryera nga operatori ekonomik për mbulimin e shpenzimeve për punonjësit e rekrutuar në mbështetje të kontratës specifike të nënshkruar midis tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 13.2.2013 “Për disa shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””;

1. Të ardhurat e realizuara nga fondet e transferuara nga ana e partive politike për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat përdoren për kryerjen e pagesave të ekspertëve kontabël të licencuar në zbatim të ligjit nr. 10 374, datë 10.2.2011 “Për partitë politike”, të ndryshuar.

m) Të ardhurat e institucioneve, të realizuara nga fondet e akorduara nga fondi i posaçëm “Për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor”.

42. Në të ardhurat jashtë limitit që nuk mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e procedurave standarde të zbatimit të buxhetit, përfshihen edhe të ardhurat e mëposhtme:

a) Të ardhura nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor;

b) Të ardhurat nga shtëpitë e pushimit të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shqiptar, si dhe të ardhurat nga shërbimi i transportit të mjeteve të bllokuara (karrotreci) dhe të ardhurat nga parkimi;

c) Të ardhurat nga privatizimi që përdoren për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore nga Ministria e Financave që lidhen me procesin e privatizimit, si dhe të ardhurat që përdoren për likuidimin e shpenzimeve të kryera për këtë proces;

d) Të ardhurat deri në 10 milionë lekë, që siguron çdo vit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nga shërbime metrologjie, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 29.8.2012;

e) Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë;

f) Të ardhurat e gjykatave nga tarifa e shërbimeve që kryen administrata gjyqësore të përcaktuar në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009.

II. KRITERE DHE PROCEDURA SPECIFIKE SHITESË PËR ZBATIMIN E BUXHETIT VENDOR

43. Transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komunë dhe qarqe) çelet 35% në tremujorin e parë, 20% në tremujorin e dytë, 20% në tremujorin e tretë dhe 25% në tremujorin e katërt.

44. Për njësitë e qeverisjes vendore:

a) Sipas aneksit 4 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, në transfertën e pakushtëzuar të bashkive: Berat, Çorovodë, Peshkopi, Burrel, Durrës, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Ersekë, Leskovik, Lezhë, Rrëshen, Rubik, Kukës, Krumë, Shkodër, Pukë, Tiranë, Vlorë, Sarandë dhe të komunave Qendër Fier, Golem Kavajë, Kelmend Malësi e Madhe dhe Bushat Shkodër, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të konvikteve të arsimit parauniversitar;

b) Për njësitë e qeverisjes vendore sipas aneksit 5 të ligjit, në transfertën e pakushtëzuar të bashkive: Berat, Elbasan, Kuçovë, Kukës dhe Shkodër, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të shërbimit dhe shpenzimet operative për qendrat “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan dhe qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkinë Kuçovë, Kukës dhe Shkodër.

Mbi këtë bazë, çdo njësi e qeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga këshilli depozitohet në Ministrinë e Financave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

45. Në vijim të përcaktimeve në udhëzimin e ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (pjesa e buxhetit vendor), jepen procedura plotësuese për vitin 2014, si më poshtë vijon:

a) Për funksionet e deleguara “Shpenzimet për mbrojtjen sociale”, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2014, detajon fondet e mbrojtjes sociale në mënyrë periodike, për çdo



njësi të qeverisjes vendore, si dhe në mënyrë specifike, për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Fondet e mbrojtjes sociale delegohen si transfertë e kushtëzuar për çdo njësi të qeverisjes vendore. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në detajimin e fondeve të mbrojtjes sociale, në mënyrë periodike, do të vlerësojë nevojat e njësive të qeverisjes vendore, duke mbajtur parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive, transparente dhe mbi bazë kriteresh të përcaktuara.

b) Fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë që shpërndahen në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e tyre bëhen publike për të gjitha bashkitë dhe komunat.

c) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë financon bashkitë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore që u shërbejnë individëve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi të bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit të bashkisë.

46. Fondet për zhvillimin e rajoneve. Fondet për zhvillimin e rajoneve do të shpërndahen në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në aneksin nr. 3 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”.

47. Të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore. Kuota që njësitë e qeverisjes vendore derdhin në favor të këshillit të qarkut, miratuar me vendim të këshillit të qarkut, është e detyrueshme për t’u zbatuar në bazë të nenit 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Fondet e krijuara nga kuotat e anëtarësimit nuk duhet të përdoren për paga dhe shpërblime për personelin administrativ të këshillit të qarkut. Strukturat përgjegjëse për thesarin në degë, me autorizim të këshillit të qarkut, bllokojnë përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk zbatojnë vendimin e këshillit të qarkut përkatës.

48. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të zbatojnë kufijtë e përcaktuar në këtë ligj për përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, si kosto për personelin administrativ. Në shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi, janë klasifikuar njësitë e qeverisjes vendore, sipas numrit të popullsisë dhe kufirit përkatës të shpenzimeve të personelit administrativ. Në shpenzimet e personelit administrativ, përshihen pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e administratës së njësisë së qeverisjes vendore (komunës/bashkisë/qarkut), jo personelit që lidhet me kryerjen e shërbimeve publike.

49. Të ardhurat nga renta minerare përdoren sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Financave. Renta e mbledhur në muajin dhjetor 2013, të cilën drejtoritë rajonale të tatimeve/doganave e raportojnë pranë Ministrisë së Financave, në vitin 2014, të llogaritet si rentë për vitin 2014, kurse renta që do të mbledhet në dhjetor 2014, të llogaritet si rentë për vitin 2015.

50. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, kur shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemin e pompimit rezultojnë debitore për furnizimin me energji elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes deri në fund të tremujorit të tretë, transferta e pakushtëzuar e njësive të qeverisjes vendore e tremujorit të katërt bllokohet me urdhër të ministrit të Financave. Njësitë e qeverisjes vendore njoftohen nëpërmjet degëve të thesarit për një bllokim të tillë dhe iu lihet një afat 5-ditor (një javë pune) për të rakorduar me sh.a. e ujësjellës-kanalizimeve dhe me kompaninë e shpërndarjes së energjisë elektrike. Njësitë vendore që kontestojnë detyrimet e tyre, duhet ta vërtetojnë një gjë të tillë nëpërmjet rakordimit me kompaninë e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ta sjellin atë brenda afatit të cituar më lart. Pas 5 ditëve (një javë pune) të bllokimit të transfertës së pakushtëzuar të tremujorit të katërt, ministri i Financave me një urdhër të dytë, transferon transfertën e pakushtëzuar nga njësia vendore në sh.a. ujësjellës-kanalizime me destinacion “Pagimin e

detyrimeve të energjisë elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe për sistemin e pompimit e kushtëzon këtë transfertë për pagimin e detyrimeve të energjisë elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes.

51. Në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore të vitit 2014, duhet të përfshihet edhe zëri i shpenzimeve për sh.a./ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve. Në këtë zë duhet të përfshihen pjesë që njësia vendore duhet t’i transferojë sh.a./ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve për mbulimin e kostos së furnizimit me ujë të pijshëm (kur kjo kosto nuk mbulohet nga tarifa).

52. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të këshillit vendor, për të gjithë tatimpaguesit (ku përfshihen si tatimpaguesit familjarë, ashtu edhe bizneset), në territorin përkatës.

III. Përcaktime të fundit

53. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë formatet e zbatimit të buxhetit bashkëlidhur, si më poshtë:

- a) Tabela 1 “Fondi i veçantë limit për vitin 2014”;
- b) Shtojca 1 “Formati i detajimit të fondeve buxhetore”;
- c) Shtojca 2 “Formati i transferimit të fondeve buxhetore”;
- d) Shtojca 3 “Zbatimi i fondit limit të pagave”;
- e) Shtojca 4 “Borderoja e pagave të njësive të qeverisjes së përgjithshme”;
- f) Shtojca 5 “Klasifikimi i njësive të qeverisjes vendore, sipas numrit të popullsisë dhe kufirit përkatës të shpenzimeve të personelit administrativ”;
- g) Shtojca 6 “Raportimi i financimeve të huaja”;
- h) Shtojca 7 “Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve buxhetorë”;
- i) Shtojca 8 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”;
- j) Shtojca 9 “Raporti i realizimit të rezultateve të programit”;
- k) Shtojca 10 “Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas rezultateve”;
- l) Shtojca 11 “Raporti i projekteve me financim të brendshëm”;
- m) Shtojca 12 “Raportimi i fondit të pagave dhe i numrit të punonjësve të njësive të qeverisjes vendore”;
- n) Shtojca 13 “Shkresa e njësive vendore për hapje llogari bankare huamarrjeje”;
- o) Shtojca 14 “Formati i raportimit të aktiveve në pronësi” sipas paragrafit 258 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012.

54. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 dhjetor 2014.

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani



TABELA NR. 1
FONDI I VEÇANTË LIMIT PËR VITIN 2014

Kod.min	Emertimi i Ministrisë / Institucionit Buxhetor	Fondi i vecantë 000/lekë
1	Presidenca	1.050
2	Kuvendi	3.700
3	Kryeministria	2.250
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	5.600
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	30.000
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	6.000
10	Ministria e Financave	43.700
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	547.000
12	Ministria e Kulturës	14.000
13	Ministria e Shëndetësisë	47.650
14	Ministria e Drejtësisë	60.800
15	Ministria e Punëve të Jashtme (Aparati 187)	1.970
16	Ministria e Brendshme	190.500
17	Ministria e Mbrojtjes	130.870
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	12.600
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	2.180
22	Akademia e Shkencës	420
24	Kontrolli i Shtetit	2.250
25	Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë	20.500
26	Ministria e Mjedisit	18.250
28	Prokuroria e Përgjithshme	11.550
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	17.550
30	Gjykata Kushtetuese	780
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	1.150
50	Instituti Statistikës	3.360
55	Shkolla e Magjistraturës	330
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	130
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	700
66	Avokati i Popullit	700
67	Komisioni i Shërbimit Civil	340
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	750
76	Inspektoriati i Lartë Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	730
77	Autoriteti i Konkurrencës	610
78	Ministria e Integritetit	1.280
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	85
87	Institucione të tjera Qeveritare	3.200
	<i>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit</i>	490
	<i>Agjencia Kombëtare e Çertifikimit Elektronik</i>	125
	<i>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar</i>	520
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	320
	<i>Komiteti Shtetëror i Minoriteteve</i>	115
	<i>Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit</i>	210
	<i>Komisioni i Prokurimit Publik</i>	280
	<i>Inspektoriati Qendror</i>	210
	<i>Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike</i>	85
	<i>Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor</i>	295
	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	310
	<i>Shkolla e Administratës Publike</i>	240
88	Mbështetje për shoqërinë civile	180
89	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	405
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	320
92	Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit	210
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	5.650
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	8.700
TOTAL		1.200.000

SHTOJCA NR. 1
FORMATI I DETAJIMIT TË FONDEVE BUXHETORE 2013 PËR NJËSINË E QEVERISJES _____
SHEMBULL: AUTORITETI I KONKURRENCËS

(Në lekë)

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	6000000	3535	33,400,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	6010000	3535	5,600,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	6020000	3535	13,000,000		
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	2310000	3535	2,500,000	M770006	Blerje autoveture
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	2310000	3535	1,000,000	M770003	Blerje pajisjesh kompjuterike
001	77	1077001	Autoriteti i Konkurrencës	01	04110	2310000	3535	500,000	M770002	Blerje pajisjesh zyre
TOTALI								56,000,000		



SHTOJCA NR. 2
FORMATI I TRANSFERIMIT TË FONDEVE BUXHETORE 2013

Lekë

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Debiti
			Pakësohet							950,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	6000000	0202			400,000
001	06	1006075	Drejtoria Rajonale Rrugore Lezhe	01	04520	6000000	2020			150,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	2300000	0202	M061903	Studim-projektim ...	400,000
			Shtohet							
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	6010000	0202			300,000
001	06	1006060	Drejtoria Rajonale Rrugore Durrës	01	04520	6010000	0707			250,000
001	06	1006055	Drejtoria Rajonale Rrugore Berat	01	04520	2310000	0202	M061860	Sistemim-asfaltim , rruga hyrëse Berat	400,000

SHTOJCA NR. 3 ZBATIMI I FONDIT LIMIT TË PAGAVE

Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahet në konsideratë që:

I. Referuar ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 2, në administratën publike, të drejtën për përcaktimin e pagës e kanë vetëm Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave.

II. Referuar ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, neni 3, paga më e lartë në institucionet e administratës publike, buxhetore dhe jobuxhetore, në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës, e cila përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit. Paga minimale mujore në shkallë vendi dhe kufiri minimal mujor për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

III. Paga e funksionarëve të lartë shtetërorë të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, i sipërcituar, përcaktohet në raport me pagën e Presidentit sipas lidhjes përkatëse të këtij ligji.

IV. Pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, të cilët janë objekt i ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, i sipërcituar, si dhe pagat e nëpunësve të administratës me arsim universitar të të gjitha njësive të qeverisjes së përgjithshme, përcaktohen me vendimin me nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime, të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim. Në këtë vendim, vlera e pagës së diplomës është e grupuar në 3 nivele dhe çdo pozicion pune ka një emërtesë të përcaktuar që i përgjigjet detyrimisht një niveli të caktuar të diplomës (pagës së grupit). Kjo nënkupton që në një funksion, i cili ka në emërtesën e tij, pagën e grupit 1, nuk mund të emërohet një nëpunës, i cili ka përfituar një diplomë të grupuar në nivelin 2. Vendimi i sipërcituar, i miratuar me ndryshime në vitin 2013, përmban disa ndryshime, ku ndër të tjera është edhe përfundimi i së drejtës për të përfituar shtesën e pagës për kushte pune për punonjësit në sektorët e IT-së, në datën 1 janar 2014. Gjithashtu, të mbahen në konsideratë, në aplikimin e shtesave për kushte pune, ndryshimet strukturore të institucioneve. Në rast se vendimi aktual, ka të parashikuar një shtesë page për punonjësit në disa njësi organizative, të cilat me ristrukturimet e kryera nuk kanë më emërtesën e përcaktuar në këtë vendim, kjo shtesë nuk është më e vlefshme për aplikim.

V. Pagat e të gjithë punonjësve të administratës publike që klasifikohen si punonjës mbështetës, pavarësisht arsimimit individual të tyre, përcaktohen në vendimin nr. 551, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave. Asnjë nëpunës nuk mund të përfitojë shtesa mbi pagë apo shpërblime, të cilat nuk janë të parashikuara në këtë vendim.

VI. Pagat e punonjësve të sistemit arsimor, të sistemit shëndetësor, të sistemit me grada, si dhe të punonjësve të Aviacionit Civil dhe Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, përcaktohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.



SHTOJCA NR.4 "BORDEROJA E PAGAVE TE NJESIVE TE QEVERISJES SE PERGJITHSHME"

Institucionit:

Kodi Institucionit

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Emri Mbiemri	Emertesa sipas strukturese se miratuar	D.pune (+L.zako nsh.)	Kategoria (klasa)	Paga grupit	Paga per funktion	Raporte mjekesore te paguara nga punedhene si (6001002)	Shtese page per vjetersi ne pune (6001003)		Shtese page per veshtiresi dhe rreziqe (600.1004)		Shtesa page per funktion ditya dhe (6001005)	Shtese page per turne te detyra dhe (6001006)	Shtesa per page per largesi nga qendra e banimit (6001007)	Shtesa page per page per Kualifikim (6001008)
							Vite	%	Lek					

25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39
Kufiri pages	Ndalesat					Shuma Neto	Dite kalenda rike pa punuar gjate muajit (e drejta per perfitim e nga gjate	Dite kale punuar ke te gjate punu ara te subj ekti gjate	Paga Bruto ne Leke		Kontribute per Sigurimet Shoqerore ne Leke			
	11,2% (Sig. shoq.)	Tatim Page	Sig.suple mentar	Te Tjera (telefon etj.)	Shuma Ndalesa				Gjithsej	Mbi te cilen llogariten kontribut et	Gjithsej	Punedhe nesi	Punemarre si	Kontribut e shtese (sigurime t suplemen tare)

Formati i Borderose eshte ndare ne dy pjese, nga te cilat:

(i) Per kolonat nga 1-24 jane futur te gjitha elementet perberes se pages me te gjitha shtesat perkatese te saj.

Per ato insitucione te cilat sipas VKM perkatese te pagave nuk l zbatohje te gjitha shtesat e paraqitura ne kete format, mund t'i heqin disa prej ketyre kolonave gjate perdorimit

(ii) Ne kolonat nga 25 -48 jane paraqitur te gjitha ndalesat perkatese

Autorizimi i fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore kryhet mbi bazen e listepageses mujore (borderose) te plotesuar detyrimisht sipas formatit te paraqitur ne shtojcen nr. 1, bashkelidhur dhe pjese perberese e ketij udhezimi.

Ky format i cili permban te gjitha elementet perberes te domosdoshem per kryerjen e pages mujore se punojesit te plotesohet i vacante per punonjesit organik dhe per punonjesit me kontrate te perkoshme pune.

Per efekt te unifikimit ky format te plotesohet duke mbajtur ne konsiderate qe muaji ka 22 dite pune.

SHTOJCA NR. 5
KLASIFIKIMI I NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE SIPAS NUMRIT TË POPULLSISË DHE KUFIRIT
PËRKATËS TË SHPENZIMEVE TË PERSONELIT ADMINISTRATIV

	Njësité vendore		Nr. i popullsisë	% e transfertës së pakushtëzuar, e lejueshme për mbulimin e kostos së personelit administrativ
Rrethi Berat				
Berat	Berat	B	63,022	deri në 15 %
Berat	Ura- Vajgurore	B	11,771	deri në 25 %
Berat	Poshnjë	K	10,186	deri në 35 %
Berat	Kutalli	K	13,111	deri në 35 %
Berat	Otilak	K	14,442	deri në 35 %
Berat	Lumas	K	7,009	deri në 40 %
Berat	Sinjë	K	5,410	deri në 40 %
Berat	Tërpan	K	2,633	deri në 45 %
Berat	Velabisht	K	11,821	deri në 35 %
Berat	Vertop	K	7,307	deri në 40 %
Berat	Roshnik	K	3,933	deri në 40 %
Berat	Cukalat	K	4,392	deri në 40 %
Rrethi Bulqizë				
Bulqizë	Bulqizë	B	12,288	deri në 25 %
Bulqizë	Fushë- Bulqizë	K	4,019	deri në 40 %
Bulqizë	Trebisht	K	1,110	deri në 45 %
Bulqizë	Ostren	K	3,000	deri në 40 %
Bulqizë	Shupenzë	K	6,892	deri në 40 %
Bulqizë	Gjoricë	K	5,333	deri në 40 %
Bulqizë	Zerqan	K	5,125	deri në 40 %
Bulqizë	Martanesh	K	2,388	deri në 45 %
Rrethi Delvinë				
Delvinë	Delvinë	B	14,031	deri në 25 %
Delvinë	Vergo	K	4,009	deri në 40 %
Delvinë	Finiq	K	6,784	deri në 40 %
Delvinë	Mesopotam	K	6,462	deri në 40 %
Rrethi Devoll				
Devoll	Bilisht	B	10,081	deri në 25 %
Devoll	Miras	K	10,462	deri në 35 %
Devoll	Qender- Bilisht	K	8,795	deri në 40 %
Devoll	Hoçisht (Moravë)	K	7,016	deri në 40 %
Devoll	Progër	K	6,013	deri në 40 %
Rrethi Dibër				
Dibër	Peshkopi	B	18,905	deri në 25 %
Dibër	Qënder Tomin	K	8,469	deri në 40 %
Dibër	Melan	K	4,405	deri në 40 %
Dibër	Kastriot	K	7,326	deri në 40 %
Dibër	Lurë	K	1,448	deri në 45 %
Dibër	Maqellarë	K	13,596	deri në 35 %
Dibër	Fushë Muhurr	K	3,514	deri në 40 %
Dibër	Selishtë	K	1,966	deri në 45 %
Dibër	Silovë	K	3,178	deri në 40 %
Dibër	Kala e Dodës	K	3,002	deri në 40 %
Dibër	Zall	K	1,208	deri në 45 %



	Dardhë			
Dibër	Zall Reç	K	1,115	deri në 45%
Dibër	Fushë-Çidhen	K	3,604	deri në 40%
Dibër	Arras	K	3,852	deri në 40%
Dibër	Luzni	K	3,172	deri në 40%
Rrethi Durrës				
Durrës	Durrës	B	207,533	deri në 15%
Durrës	Shijak	B	13,076	deri në 25%
Durrës	Manëz	B	11,447	deri në 25%
Durrës	Sukth	B	26,648	deri në 20%
Durrës	Rashbull	K	28,952	deri në 30%
Durrës	Xhafzotaj	K	17,973	deri në 30%
Durrës	Gjepalaj	K	5,873	deri në 40%
Durrës	Katund i Ri	K	15,545	deri në 30%
Durrës	Maminas	K	7,076	deri në 40%
Durrës	Ishëm	K	8,879	deri në 40%
Rrethi Elbasan				
Elbasan	Elbasan	B	125,482	deri në 15%
Elbasan	Cërrik	B	14,850	deri në 25%
Elbasan	Belsh	B	14,156	deri në 25%
Elbasan	Bradashesh	K	9,671	deri në 40%
Elbasan	Funarë	K	3,101	deri në 40%
Elbasan	Gostimë	K	12,672	deri në 35%
Elbasan	Gracen	K	5,681	deri në 40%
Elbasan	Grekan	K	5,045	deri në 40%
Elbasan	Gjinar	K	4,910	deri në 40%
Elbasan	Gjergjan	K	7,766	deri në 40%
Elbasan	Kajan	K	6,564	deri në 40%
Elbasan	Fierzë	K	4,012	deri në 40%
Elbasan	Klos	K	4,283	deri në 40%
Elbasan	Labinot Mal	K	5,687	deri në 40%
Elbasan	Labinot Fushë	K	6,515	deri në 40%
Elbasan	Mollas	K	7,733	deri në 40%
Elbasan	Papër	K	9,020	deri në 40%
Elbasan	Rrasë	K	2,498	deri në 45%
Elbasan	Shalëz	K	6,997	deri në 40%
Elbasan	Shirgjan	K	10,173	deri në 35%
Elbasan	Shushicë	K	10,909	deri në 35%
Elbasan	Tregan	K	4,431	deri në 40%
Elbasan	Zavalinë	K	1,978	deri në 45%
Rrethi Fier				
Fier	Fier	B	86,616	deri në 15%
Fier	Patos	B	31,029	deri në 20%
Fier	Roskovec	B	8,633	deri në 25%
Fier	Mbrostar	K	10,515	deri në 35%
Fier	Libofshë	K	10,369	deri në 35%
Fier	Dermenas	K	12,548	deri në 35%
Fier	Topojë	K	7,592	deri në 40%
Fier	Levan	K	17,508	deri në 30%
Fier	Frakull	K	10,516	deri në 35%
Fier	Portëz	K	11,314	deri në 35%
Fier	Qendër (Çlirim)	K	12,298	deri në 35%
Fier	Ruzhdië	K	3,318	deri në 40%

Fier	Zharrëz	K	8,358	deri në 40 %
Fier	Kurjan	K	5,322	deri në 40 %
Fier	Kuman	K	8,369	deri në 40 %
Fier	Strumë	K	9,145	deri në 40 %
Fier	Cakran	K	16,656	deri në 30 %
Rrethi Gramsh				
Gramsh	Gramsh	B	12,910	deri në 25 %
Gramsh	Pishaj	K	6,525	deri në 40 %
Gramsh	Kodovjat	K	3,355	deri në 40 %
Gramsh	Kukur	K	3,317	deri në 40 %
Gramsh	Skëndërbeg as	K	2,288	deri në 45 %
Gramsh	Poroçan	K	1,978	deri në 45 %
Gramsh	Lënie	K	1,119	deri në 45 %
Gramsh	Tunjë	K	2,235	deri në 45 %
Gramsh	Sult	K	1,384	deri në 45 %
Gramsh	Kushovë	K	1,144	deri në 45 %
Rrethi Gjirokastër				
Gjirokastër	Gjirokastër	B	33,281	deri në 20 %
Gjirokastër	Libohovë	B	3,363	deri në 25 %
Gjirokastër	Qendër Libohovë	K	2,647	deri në 45 %
Gjirokastër	Odrë	K	1,480	deri në 45 %
Gjirokastër	Lunxhëri	K	5,653	deri në 40 %
Gjirokastër	Antigonë	K	1,565	deri në 45 %
Gjirokastër	Lazarat	K	3,444	deri në 40 %
Gjirokastër	Cepo	K	4,610	deri në 40 %
Gjirokastër	Picar	K	1,976	deri në 45 %
Gjirokastër	Dropull i Poshtëm	K	9,524	deri në 40 %
Gjirokastër	Dropull i Sipërm	K	10,492	deri në 35 %
Gjirokastër	Pogon	K	3,123	deri në 40 %
Gjirokastër	Zagorie	K	1,145	deri në 45 %
Rrethi Has				
Has	Krumë	B	7,581	deri në 25 %
Has	Golaj	K	8,090	deri në 40 %
Has	Fajzë	K	4,174	deri në 40 %
Has	Gjinaj	K	1,338	deri në 45 %
Rrethi Kavajë				
Kavajë	Kavajë	B	40,232	deri në 20 %
Kavajë	Rrogozhinë	B	11,655	deri në 25 %
Kavajë	Lekaj	K	9,288	deri në 40 %
Kavajë	Luz i Vogël	K	10,466	deri në 35 %
Kavajë	Helmes	K	5,018	deri në 40 %
Kavajë	Kryevidh	K	9,150	deri në 40 %
Kavajë	Synej	K	10,765	deri në 35 %
Kavajë	Golem	K	12,519	deri në 35 %
Kavajë	Sinaballaj	K	1,898	deri në 45 %
Kavajë	Gosë	K	8,568	deri në 40 %
Rrethi Kolonjë				
Kolonjë	Ersekë	B	6,829	deri në 25 %
Kolonjë	Leskovik	B	2,472	deri në 25 %
Kolonjë	Qendër	K	4,077	deri në 40 %
Kolonjë	Mollas	K	3,377	deri në 40 %
Kolonjë	Çlirim	K	792	deri në 45 %



Kolonjë	Barmash	K	838	deri në 45 %
Kolonjë	Piskal- Novoselë	K	720	deri në 45 %
Kolonjë	Qendër Leskovik	K	880	deri në 45 %
Rrethi Korçë				
Korçë	Korçë	B	86,739	deri në 15 %
Korçë	Maliq	B	7,733	deri në 25 %
Korçë	Voskopojë	K	1,916	deri në 45 %
Korçë	Lekas	K	687	deri në 45 %
Korçë	Vithkuq	K	2,561	deri në 45 %
Korçë	Pustec	K	5,190	deri në 40 %
Korçë	Pojan	K	17,113	deri në 30 %
Korçë	Vreshtas	K	10,681	deri në 35 %
Korçë	Libonik	K	13,755	deri në 35 %
Korçë	Pirg	K	9,931	deri në 40 %
Korçë	Gore	K	4,209	deri në 40 %
Korçë	Moglicë	K	1,012	deri në 45 %
Korçë	Voskop	K	6,038	deri në 40 %
Korçë	Drenovë	K	10,713	deri në 35 %
Korçë	Mollas	K	6,582	deri në 40 %
Korçë	Qendër Bulgarec	K	13,911	deri në 35 %
Rrethi Krujë				
Krujë	Krujë	B	16,334	deri në 25 %
Krujë	Fushë- Krujë	B	25,816	deri në 20 %
Krujë	Nikël	K	9,935	deri në 40 %
Krujë	Bubq	K	8,363	deri në 40 %
Krujë	Kodër Thumanë	K	15,838	deri në 30 %
Krujë	Cudhi	K	3,133	deri në 40 %
Rrethi Kuçovë				
Kuçovë	Kuçovë	B	29,734	deri në 20 %
Kuçovë	Perondi	K	10,530	deri në 35 %
Kuçovë	Kozarë	K	7,942	deri në 40 %
Rrethi Kukës				
Kukës	Kukës	B	20,981	deri në 20 %
Kukës	Malzi	K	3,824	deri në 40 %
Kukës	Bicaj	K	6,244	deri në 40 %
Kukës	Ujmisht	K	2,310	deri në 45 %
Kukës	Tërthorë	K	3,337	deri në 40 %
Kukës	Shtiqën	K	3,517	deri në 40 %
Kukës	Zapod	K	3,068	deri në 40 %
Kukës	Shishtavec	K	5,106	deri në 40 %
Kukës	Topojan	K	2,611	deri në 45 %
Kukës	Bushticë	K	1,576	deri në 45 %
Kukës	Surroj	K	1,566	deri në 45 %
Kukës	Arren	K	772	deri në 45 %
Kukës	Kolsh	K	1,579	deri në 45 %
Kukës	Kalis	K	1,402	deri në 45 %
Kukës	Grykë-Çaje	K	1,400	deri në 45 %
Rrethi Kurbin				
Kurbin	Laç	B	29,426	deri në 20 %
Kurbin	Mamurras	B	22,787	deri në 20 %
Kurbin	Milot	K	11,909	deri në 35 %
Kurbin	Fushë-	K	8,692	deri në 40 %

	Kuqe			
Rrethi Lezhë				
Lezhë	Lezhë	B	29,176	deri në 20%
Lezhë	Zejmen	K	9,225	deri në 40%
Lezhë	Shënkoll	K	16,300	deri në 30%
Lezhë	Shëngjin	K	11,826	deri në 35%
Lezhë	Kolsh	K	6,848	deri në 40%
Lezhë	Ballëdren i Ri	K	10,134	deri në 35%
Lezhë	Kallmet	K	6,992	deri në 40%
Lezhë	Ungrej	K	3,114	deri në 40%
Lezhë	Dajç	K	7,022	deri në 40%
Lezhë	Blinisht	K	5,456	deri në 40%
Rrethi Librazhd				
Librazhd	Librazhd	B	10,630	deri në 25%
Librazhd	Prrenjas	B	8,757	deri në 25%
Librazhd	Qukës	K	10,800	deri në 35%
Librazhd	Stravaj	K	3,035	deri në 40%
Librazhd	Hotolisht	K	7,108	deri në 40%
Librazhd	Polis	K	5,157	deri në 40%
Librazhd	Qendër	K	11,282	deri në 35%
Librazhd	Lunik	K	3,679	deri në 40%
Librazhd	Orenjë	K	5,193	deri në 40%
Librazhd	Stëblevë	K	1,052	deri në 45%
Librazhd	Rrajcë	K	10,361	deri në 35%
Rrethi Lushnjë				
Lushnjë	Lushnjë	B	53,712	deri në 15%
Lushnjë	Divjakë	B	13,843	deri në 25%
Lushnjë	Ballagat	K	3,644	deri në 40%
Lushnjë	Hysgjokaj	K	3,575	deri në 40%
Lushnjë	Golem	K	7,729	deri në 40%
Lushnjë	Fier			
Lushnjë	Shegan	K	9,421	deri në 40%
Lushnjë	Karbunarë	K	5,582	deri në 40%
Lushnjë	Allkaj	K	6,216	deri në 40%
Lushnjë	Krutje	K	10,237	deri në 35%
Lushnjë	Bubullimë	K	7,156	deri në 40%
Lushnjë	Kolonjë	K	8,432	deri në 40%
Lushnjë	Gradishtë	K	10,706	deri në 35%
Lushnjë	Rremas	K	6,629	deri në 40%
Lushnjë	Grabian	K	6,419	deri në 40%
Lushnjë	Tërbuf	K	15,660	deri në 30%
Lushnjë	Dushk	K	11,543	deri në 35%
Rrethi Malësi e Madhe				
Malësi e Madhe	Koplik	B	10,750	deri në 25%
Malësi e Madhe	Qendër	K	5,948	deri në 40%
Malësi e Madhe	Kelmend	K	6,233	deri në 40%
Malësi e Madhe	Kastrat	K	11,943	deri në 35%
Malësi e Madhe	Shkrelë	K	5,949	deri në 40%
Malësi e Madhe	Gruemirë	K	13,027	deri në 35%
Rrethi Mallakastër				
Mallakastër	Ballsh	B	12,577	deri në 25%
Mallakastër	Qendër	K	8,902	deri në 40%
Mallakastër	Hekal	K	4,844	deri në 40%
Mallakastër	Aranitas	K	3,668	deri në 40%



Mallakastër	Fratar	K	5,020	deri në 40 %
Mallakastër	Kute	K	3,358	deri në 40 %
Mallakastër	Kapaj	K	1,764	deri në 45 %
Mallakastër	Ngracan	K	806	deri në 45 %
Mallakastër	Greshicë	K	2,051	deri në 45 %
Rrethi Mat				
Mat	Burrel	B	16,829	deri në 25 %
Mat	Klos	B	10,032	deri në 25 %
Mat	Komsi	K	5,211	deri në 40 %
Mat	Ulëz	K	1,927	deri në 45 %
Mat	Baz	K	3,168	deri në 40 %
Mat	Rukaj	K	3,486	deri në 40 %
Mat	Derjan	K	1,451	deri në 45 %
Mat	Macukull	K	1,848	deri në 45 %
Mat	Lis	K	4,665	deri në 40 %
Mat	Suç	K	3,426	deri në 40 %
Mat	Gurë	K	4,033	deri në 40 %
Mat	Xibër	K	3,336	deri në 40 %
Rrethi Mirditë				
Mirditë	Rrëshen	B	14,156	deri në 25 %
Mirditë	Rubik	B	7,960	deri në 25 %
Mirditë	Kaçinar	K	2,116	deri në 45 %
Mirditë	Orosh	K	3,240	deri në 40 %
Mirditë	Fan	K	4,735	deri në 40 %
Mirditë	Kthellë	K	3,103	deri në 40 %
Mirditë	Selitë	K	2,070	deri në 45 %
Rrethi Peqin				
Peqin	Peqin	B	9,893	deri në 25 %
Peqin	Gjocaj	K	7,215	deri në 40 %
Peqin	Karinë	K	1,885	deri në 45 %
Peqin	Pajovë	K	8,876	deri në 40 %
Peqin	Përparim	K	5,505	deri në 40 %
Peqin	Shezë	K	5,407	deri në 40 %
Rrethi Përmet				
Përmet	Përmet	B	10,099	deri në 25 %
Përmet	Këlcyrë	B	5,057	deri në 25 %
Përmet	Çarshovë	K	3,044	deri në 40 %
Përmet	Qendër Piskovë	K	3,112	deri në 40 %
Përmet	Sukë	K	2,648	deri në 45 %
Përmet	Ballaban	K	2,147	deri në 45 %
Përmet	Deshnicë	K	2,606	deri në 45 %
Përmet	Frashër	K	930	deri në 45 %
Përmet	Petran	K	3,138	deri në 40 %
Rrethi Pogradec				
Pogradec	Pogradec	B	38,637	deri në 20 %
Pogradec	Buçimas	K	17,600	deri në 30 %
Pogradec	Hudenisht	K	7,825	deri në 40 %
Pogradec	Proptisht	K	6,525	deri në 40 %
Pogradec	Velçan	K	3,661	deri në 40 %
Pogradec	Trebinjë	K	3,250	deri në 40 %
Pogradec	Dardhas	K	3,532	deri në 40 %
Pogradec	Çerravë	K	9,807	deri në 40 %
Rrethi Pukë				
Pukë	Pukë	B	6,882	deri në 25 %
Pukë	Fushë-	B	4,045	deri në 25 %

	Arrëz			
Pukë	Qerret	K	1,905	deri në 45%
Pukë	Qelëz	K	1,498	deri në 45%
Pukë	Gjegjan	K	4,303	deri në 40%
Pukë	Fierzë	K	2,040	deri në 45%
Pukë	Iballë	K	2,015	deri në 45%
Pukë	Blerim	K	1,527	deri në 45%
Pukë	Qafë-Mali	K	2,060	deri në 45%
Pukë	Rrapë	K	2,294	deri në 45%
Rrethi Sarandë				
Sarandë	Sarandë	B	41,308	deri në 20%
Sarandë	Konispol	B	3,068	deri në 25%
Sarandë	Lukovë	K	9,702	deri në 40%
Sarandë	Dhivër	K	6,514	deri në 40%
Sarandë	Livadhja	K	10,440	deri në 35%
Sarandë	Xarrë	K	7,578	deri në 40%
Sarandë	Markat	K	3,067	deri në 40%
Sarandë	Ksamil	K	9,206	deri në 40%
Sarandë	Aliko	K	8,873	deri në 40%
Rrethi Skrapar				
Skrapar	Çorovodë	B	6,362	deri në 25%
Skrapar	Polican	B	8,439	deri në 25%
Skrapar	Qendër	K	4,088	deri në 40%
Skrapar	Potom	K	1,169	deri në 45%
Skrapar	Leshnjë	K	722	deri në 45%
Skrapar	Cepan	K	1,114	deri në 45%
Skrapar	Vendreshe	K	1,596	deri në 45%
Skrapar	Bogovë	K	1,661	deri në 45%
Skrapar	Zhepë	K	1,043	deri në 45%
Skrapar	Gjerbes	K	1,327	deri në 45%
Rrethi Shkodër				
Shkodër	Shkodër	B	112,139	deri në 15%
Shkodër	Vau i Dejës	B	12,559	deri në 25%
Shkodër	Postribë	K	11,543	deri në 35%
Shkodër	Pult	K	3,130	deri në 40%
Shkodër	Shosh	K	1,522	deri në 45%
Shkodër	Shalë	K	3,914	deri në 40%
Shkodër	Shllak	K	1,874	deri në 45%
Shkodër	Gur i Zi	K	11,442	deri në 35%
Shkodër	Vig-Mnelë	K	2,445	deri në 45%
Shkodër	Hajmel	K	5,985	deri në 40%
Shkodër	Bushat	K	23,531	deri në 30%
Shkodër	Bërdicë	K	9,359	deri në 40%
Shkodër	Velipojë	K	9,362	deri në 40%
Shkodër	Dajç (Bregbunë)	K	8,839	deri në 40%
Shkodër	Ana e Malit	K	5,913	deri në 40%
Shkodër	Rrethinat	K	23,397	deri në 30%
Shkodër	Temal	K	2,393	deri në 45%
Rrethi Tepelenë				
Tepelenë	Tepelenë	B	8,021	deri në 25%
Tepelenë	Memaliaj	B	6,890	deri në 25%
Tepelenë	Qendër	K	5,870	deri në 40%
Tepelenë	Fshat Memaliaj	K	2,704	deri në 45%
Tepelenë	Krahëz	K	4,175	deri në 40%
Tepelenë	Qesarat	K	2,453	deri në 45%



Tepelenë	Luftinjë	K	3,813	deri në 40 %
Tepelenë	Buz	K	1,483	deri në 45 %
Tepelenë	Kurvelesh	K	1,426	deri në 45 %
Tepelenë	Lopez	K	1,090	deri në 45 %
Rrethi Tiranë				
Tiranë	Tiranë	B	639,929	deri në 15 %
Tiranë	Vorë	B	19,321	deri në 25 %
Tiranë	Kamëz	B	84,972	deri në 15 %
Tiranë	Petrelë	K	6,476	deri në 40 %
Tiranë	Bërzhitë	K	5,795	deri në 40 %
Tiranë	Baldushk	K	5,352	deri në 40 %
Tiranë	Zall Bastar	K	5,536	deri në 40 %
Tiranë	Shëngjergj	K	2,777	deri në 45 %
Tiranë	Dajt	K	13,671	deri në 35 %
Tiranë	Vaqarr	K	9,548	deri në 40 %
Tiranë	Pezë	K	5,747	deri në 40 %
Tiranë	Ndroq	K	9,188	deri në 40 %
Tiranë	Prezë	K	6,842	deri në 40 %
Tiranë	Zall Herr	K	10,906	deri në 35 %
Tiranë	Paskuqan	K	40,229	deri në 30 %
Tiranë	Bërxullë	K	9,906	deri në 40 %
Tiranë	Kashar	K	23,324	deri në 30 %
Tiranë	Farkë	K	12,316	deri në 35 %
Tiranë	Krrabë	K	3,101	deri në 40 %
Rrethi Tropojë				
Tropojë	Bajram Curri	B	8,203	deri në 25 %
Tropojë	Fshat Tropojë	K	5,456	deri në 40 %
Tropojë	Bytyç	K	2,099	deri në 45 %
Tropojë	Lekbibaj	K	1,919	deri në 45 %
Tropojë	Fierzë	K	2,475	deri në 45 %
Tropojë	Margegaj	K	2,999	deri në 45 %
Tropojë	Bujan	K	2,884	deri në 45 %
Tropojë	Llugaj	K	2,155	deri në 45 %
Rrethi Vlorë				
Vlorë	Vlorë	B	136,987	deri në 15 %
Vlorë	Orikum	B	11,712	deri në 25 %
Vlorë	Selenicë	B	6,901	deri në 25 %
Vlorë	Himarë	B	13,316	deri në 25 %
Vlorë	Qendër	K	18,584	deri në 30 %
Vlorë	Novoselë	K	16,852	deri në 30 %
Vlorë	Brataj	K	4,984	deri në 40 %
Vlorë	Hore Vranisht	K	4,026	deri në 40 %
Vlorë	Shushicë	K	9,503	deri në 40 %
Vlorë	Vllahinë	K	7,250	deri në 40 %
Vlorë	Kote	K	6,697	deri në 40 %
Vlorë	Sevastar	K	3,204	deri në 40 %
Vlorë	Armen	K	6,797	deri në 40 %

SHTOJCA NR. 6

NJËSIA E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

RAPORTIMI I FINANCIMEVE TË HUAJA PËR VITIN 2012, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 775, DATË 24.9.2010 DHE UDHËZIMIT TË MINISTRISË SË FINANCAVE

[illegible]

DREJTORI

FINANCIERI



SHTOJCA NR. 7
RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE BUXHETORË

KRYEORIENTIMET E PRANIMIT DHE PROGRAMIT DHE PAS PRANIMIT DHE PROGRAMIT									
Grupi								Kodi	
Programi								Titulli	
				Totali i shpenzimeve					
				(1) MTBP Plani 2008	(2) Buxheti 2008	(3) Buxheti i rishikuar 2008	(4) Fakti 2008	(5)=(2)-(4) Diferenca 2008	
Artikulli Kodi	Emri								
600	Paga								
601	Sigurime shoqërore								
602	Mallra dhe shërbime të tjera								
603	Subvencione								
604	Transferta korrente të brendshme								
605	Transferta korrente të huaja								
606	Trans për buxh. fam. dhe individ								
Nëntotali	Shpenzime korrente	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			
230	Kapitale të patrupëzuara								
231	Kapitale të trupëzuara								
232	Transferta kapitale								
Nëntotali	Shpenzime kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			
Totali		Korrente dhe kapitale		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Jashtëbuxhetore				0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali (korrente + kapitale + jashtëbuxhetore)				0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Drejtuesi i ekipit menaxhues të programit	Emri			Sekretari i përgjithshëm	Emri				
	Firma				Firma				
	Data				Data				

SHTOJCA NR. 8
RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

Emri i grupit		Kodi i grupit			
Programet		Shpenzimet e ministrisë			
		PBA Plani 2008	Buxheti 2008	Fakti 2008	Diferenca 2008
Titulli	Emri				
0001	Programi 1	0.0	0.0	0.0	0.0
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali i shpenzimeve të ministrisë		0.0	0.0	0.0	0.0

Sekretari i përgjithshëm	Emri	
	Firma	
	Data	



SHTOJCA NR. 9
RAPORTI I REALIZIMIT TË REZULTATEVE TË PROGRAMIT

Grupi					Kodi			
Programi					Titulli			
Kodi i rezultatit	Emri i rezultatit	Njësia matëse	Sasia e planifikuar	Sasia e realizuar	Realizimi			Komente
					Plotësisht	Pjesërisht	Aspak	
A	Rezultati A							
B	Rezultati B							
C	Rezultati C							
D	Rezultati D							
E	Rezultati E							

Drejtuesi i ekipit menaxhues të programit	Emri		Sekretari i përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	

SHTOJCA NR. 10
RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS REZULTATEVE

KODI I SHPENZIMET E PLANIT 12 PROGRAMIT SHIS REZULTATIT 12					
Grupi				Kodi	
Programi				Titulli	
		Shpenzimet e rezultatit			
Kodi i			PBA	Buxheti	Fakti
rezultatit	Emri i rezultatit		Plani 2008	2008	2008
A	Rezultati A		0.0	0.0	0.0
B	Rezultati B		0.0	0.0	0.0
C	Rezultati C		0.0	0.0	0.0
D	Rezultati D		0.0	0.0	0.0
E	Rezultati E		0.0	0.0	0.0

Drejtuesi i ekipit menaxhues të programit	Emri		Sekretari i përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	



SHTOJCA NR. 11
PROJEKTET ME FINANCIM TË BRENDSHËM

000/ lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Buxheti
			Kontraktuar

PROJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ

000/ lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Grant/kredi	Vlera e plotë e projektit	Shpenzimi realizuar

SHTOJCA NR. 12
RAPORTIMI I FONDIT TË PAGAVE DHE I NUMRIT TË PUNONJËSVE TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE

Emri i njësisë				
	Viti 2009 (fakti)		Viti 2010	
	Numri i punonjësve	Fondi i pagave (në lekë)	Numri i punonjësve	Fondi i pagave (në lekë)
Administrata e njësisë	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjës me kontratë (administrata)	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet e varësisë	0.0	0.0	0.0	0.0
Punonjës me kontratë (institucionet e varësisë)	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	0.0	0.0	0.0	0.0



SHTOJCA NR. 13
SHKRESA E NJËSIVE VENDORE PËR HAPJE LLOGARIE HUAMARRJEJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSIME E THESARIT
DREJTORIA OPERACIONALE

Nr. 13.881/2010 Prot.

Tirane, më 27.04.2010

Peri: BANKA KOMBETARE TREGTARE

Per njoftim: Dega e Thesarit Elbasan
Bashkia Elbasan


Subjekti: Kerkese per hapje llogarie

Ne zbatim te Ligjit Nr.9869, dt.04.02.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" si dhe Udhhezimit te Ministrise se Financave Nr.35, dt. 05.04.2008 "Per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", lutemi te hapni prane Bankes Kombetare Tregtare Dega Elbasan, llogarine tranzite per Huamarrjen e Qeverisjes Vendore: "Dega e Thesarit Elbasan-Huamarrje Njesia Vendore" ne LEKE.

Kjo llogari du te funksionoj ne perputhje me Akt-Marrevoshjen midis Ministrise se Financave dhe Bankes tuaj.

Pas hapjes se kesaj llogarie, lutemi njoftoni numrin e saj IBAN prane Dages se Thesarit Elbasan dhe Ministrise se Financave - Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit - Drejtoria Operacionale,

Ridvan BODE



SHTOJCA NR. 14/1
FORMATI I RAPORTIMIT TË AKTIVEVE NË PRONËSI
OBJEKTET SHETËTËRORE TË DHËNA ME QIRA NGA NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME
MINISTRIA/INSTITUCIONI _____

Nr.	Emërtimi i objekteve të dhëna me qira	Sip. e objekt. m ²	Afati i qirasë	Veprimtaria që kryhet	Qiraja mujore	Arkëtimet					Adresa e plotë e subjektit përfitues të objektit me qira
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	xxx	
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											



SHTOJCA NR. 14/2
FORMATI I RAPORTIMIT TË AKTIVEVE NË PRONËSI
TË DHËNA PËR SUBJEKTET/NDËRMARRJET/KOMPANITË ETJ. ME KAPITAL TËRËSISHT/PJESËRISHT SHTETËROR
MINISTRIA E _____

Nr.	Emërtimi: subjekt/ndërm./kompani etj.	Statusi: sh.a., sh.p.k., ndërm. etj.	Pjesëmarrja e shtetit %	NIPT-i: subjekt/ndërm./ kompani etj.	Dividenti			Adresa e plotë e qendrës së subjektit, ndërmarrjes, kompanisë apo formave të tjera të parashikuara me ligj
					Viti raportues		Viti planif.	
					Realizuar	Derdhur	Parash	
a	b	c	d	e				f
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
	SHUMA							

SHTOJCA NR. 14/3
FORMATI I RAPORTIMIT TË AKTIVEVE NË PRONËSI
PASQYRA PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE TË DHËNA ME KONCESION
MINISTRIA E _____

Nr.	Shoqëria koncesionare	Objekti i koncesionit	NIPT-i	Afati i konces. në vite	Kushti bazë i pagesës	Fillimi i pagesës	Arkëtuar				Adresa e plotë e selisë së shoqërisë koncesionare nr. kontakti: tel., cel.
							Deri në vitin xxx	Viti raportues		Viti pl. parash	
								Llog.	Derdh.		
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											
16											
17											
18											



UDHËZIM
Nr. 4, datë 25.1.2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10, pika 1 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2.1, germa “ç” e udhëzimit ndryshohet si më poshtë:

“ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore për procedurat, të drejtat dhe përgjegjësitë tatimore, të cilat nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet që i janë bërë ose mund t’i bëhen atij ligji në të ardhmen.”

2. Pika 15 e udhëzimit ndryshon në përmbajtje si vijon:

“15. Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore me përjashtim të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore vlerëson, mbledh, kontrollon dhe arkëton tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.”

3. Pika 45.1.2 e udhëzimit ndryshon në përmbajtje si vijon:

“45.1.2 Drejtoria Rajonale e Tatimeve e juridiksionit përkatës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit nga QKR-ja për fillimin e procedurave të çregjistrimit, verifikon situatën tatimore të subjekteve deri në çastin e aplikimit për çregjistrim në QKR, për personat fizikë ose juridikë, ose deri në çastin e aplikimit për fillimin e procedurave të likuidimit në QKR ose në gjykatë për OJF-të, fondacionet dhe ente të tjera publike. Verifikimi përfshin të gjitha llojet e detyrimeve tatimore të personit të tatueshëm, përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe gjobat e kamatëvonesat eventuale të lidhura me këto detyrime. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, përveç verifikimit të situatës tatimore, kur është e nevojshme, ushtron kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti, sipas një analize risku.”

4. Fjalía e tretë dhe katërt në paragrafin 43.2.1 ndryshon si vijon:

“Rast i ndryshimit të përgjegjësisë tatimore mund të jetë, për shembull, tejkalimi i volumit të qarkullimit prej 8 milionë lekësh në vit kalendarik. Në këtë rast, përgjegjësia tatimore e personit të tatueshëm ndryshon, domethënë nga person i tatueshëm i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël duhet të kalojë në tatimpagues i tatimit mbi fitimin.”

5. Në pikën 46.1.3, në fund të fjalisë, shtohet togfjalëshi “apo kur marrësi i furnizimit, edhe kur nuk është personi i tatueshëm, e kërkon faturën”.

6. Në pikat 43.2.3, 47.1.2, 47.1.3, 47.1.4, 47.1.5, 47.1.7, 54.5, 55, 58.1, 59.2.1, togfjalëshi “tatimpagues/subjekt i taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe të tatimit mbi të ardhurat (personale)” ndryshohet me togfjalëshin “tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

7. Në pikën 47.1.1, fjalía e parë ndryshon në përmbajtje si vijon:

“Personi i tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe i tatimit mbi të ardhurat, kur kryen një furnizim mallrash apo shërbimesh, në momentin e furnizimit, është i detyruar të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore në lidhje me atë furnizim për çdo person të tatueshëm që merr furnizimin, përveç rasteve kur, në bazë të legjislacionit tatimor në fuqi, është

person i tatueshëm i TVSH-së dhe është i detyruar të lëshojë faturë me TVSH. Forma dhe përmbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në ligjin “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në udhëzimin në zbatim të këtij ligji “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”. Për blerësin, person i tatueshëm, subjekt i çfarëdolloj tatimi, kjo faturë shërben si dokument justifikues për shpenzimet e zbritshme të biznesit.”

8. Në pikën 49.1, fjalia e parë ndryshon në përmbajtje si vijon:

“Faturë tatimore konsiderohet fatura me TVSH, e cila lëshohet nga personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo subjekte të tatimit mbi fitimin dhe fatura e thjeshtë tatimore, e cila lëshohet nga persona të tatueshëm, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, kur nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar, si dhe nga organizatat jofitimprurëse, fondacionet, institucionet buxhetore etj.”

9. Në fjalinë e katërt të pikës 49.1, togfjalëshi “të tatimit mbi të ardhurat personale” zëvendësohet me togfjalëshin “të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël”.

10. Pika 57.5 ndryshon në përmbajtje si vijon:

“57.5 Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për përllogaritjen e detyrimit tatimor, janë të detyruar të mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe të lëshojnë fatura tatimore, dëftesa tatimore dhe kuponë tatimorë, në përputhje me ligjin “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe udhëzimin “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, në zbatim të tij. Këto regjistrime do të shërbejnë si bazë për vetëvlerësimin dhe vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm apo, kur është rasti, për përcaktimin e detyrimit tatimor.

Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që janë të regjistruar në TVSH, libri i shitjeve dhe libri i blerjeve, të mbajtura për efekte të TVSH-së, shërbejnë si të tillë edhe për efekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.”

11. Në fjalinë e parë të pikës 59.1.1, fjalët “300 mijë lekë” zëvendësohen me fjalët “150 mijë lekë”.

12. Në pikën 64.2.1, fjalia e fundit ndryshohet në përmbajtje si vijon:

“Kurse për personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, periudhat tatimore për llogaritjen, deklarimin dhe pagesat e tatimit janë sipas ligjit “Për sistemin e taksave vendore” dhe udhëzimin në zbatim të tij “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, si dhe janë periudha tremujore për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.”

13. Në pikën 68.2.1, fjalia e fundit ndryshon në përmbajtje si vijon:

“Të tilla janë deklarimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, të tatimit mbi fitimin, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël etj.”

14. Pika 68.2.3 ndryshon në përmbajtje si vijon:

“68.2.3 Parapagimi i detyrimit tatimor, i cili përdoret në rastin e parapagimit të tatimit mbi fitimin gjatë vitit ushtrimor dhe të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është, gjithashtu, vetëvlerësim tatimor.

Llogaritja e kësteve të parapagimit të tatimit mbi fitimin dhe pagesa e tyre bazohet në mënyrën dhe afatet e parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Vetëvlerësimi përfundimtar i detyrimit tatimor bëhet në momentin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme (të fitimit/humbjes).

Llogaritja e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël apo pagesa e detyrimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël bazohet në mënyrën e parashikuar në ligjin “Për sistemin e taksave vendore” dhe udhëzimit në zbatim të tij “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”. Vlerësimi përfundimtar i detyrimit tatimor të biznesit të vogël, për subjektet, të cilat kanë detyrim për të deklaruar, bëhet në momentin e paraqitjes së



deklaratës vjetore (formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin), siç përcaktohet në ligjin “Për sistemin e taksave vendore” dhe udhëzimin në zbatim të tij.”

15. Pikat 69.1 dhe 69.4 ndryshojnë në përmbajtje si vijon:

“69.1 Njoftimi i vlerësimit tatimor, i bërë nga administrata tatimore për personin e tatueshëm, duhet t’i dërgohet personit me postë rekomande, brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të tij. Data e lëshimit të njoftimit të vlerësimit tatimor, konsiderohet data e plotësimit të tij, e cila shënohet në rubrikën përkatëse të formularit të njoftimit të vlerësimit. Njoftimi i vlerësimit tatimor, i dërguar me postë rekomande në adresën e personit të tatueshëm, merret ose konsiderohet se është marrë nga ky i fundit, 10 ditë nga data e nisjes me postë. Me hyrjen në fuqi të njoftimit të vlerësimit tatimor, siç përcaktohet në pikën 68.3.2 të këtij udhëzimi, lind detyrimi për të paguar detyrimin tatimor të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit tatimor.”

“69.4 Personi i tatueshëm, që nuk është dakord me njoftimin e vlerësimit tatimor, ka të drejtë ta ankimojë atë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit në përputhje me procedurat e parashikuara në kreun XIII të ligjit. Në rastet kur nuk mund të provohet e saktë data e marrjes së vlerësimit të detyrimit tatimor, konsiderohet të jetë marrë 10 (dhjetë) ditë nga data e nisjes me postë.”

16. Pika 70.3 ndryshohet në përmbajtje si vijon:

“70.3 Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për llojet e taksave që administron, për të gjithë personat e tatueshëm, subjekte të taksave vendore, përfshirë edhe tatimpaguesit që klasifikohen si biznes i vogël.

Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse.”

17. Në pikën 71, shkronja “e”, fjalët “300 mijë lekë” zëvendësohen me fjalët “150 mijë lekë”.

18. Pika 75/1.2, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Me administrimin e kësaj kërkesë, drejtoria rajonale tatimore, brenda një periudhe 60-ditore nga data e regjistrimit të saj në protokollin e organit tatimor, duhet të verifikojë pretendimin e tatimpaguesit.”

19. Pika 83.4 ndryshohet në përmbajtje si më poshtë:

“83.4 Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.”

20. Në pikën 90.2, togfjalëshi “ekzekutohet i pari” zëvendësohet me togfjalëshin “ekzekutohet sipas radhës së përcaktuar në nenin 605 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”

21. Pika 92.3 ndryshon në përmbajtje si vijon:

“92.3 Në qoftë se drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo titullari i njësisë së ngjashme me të nuk miraton kërkesën e tatimpaguesit, tatimpaguesi mund ta ankimojë këtë vendim brenda afateve dhe në formën, mënyrën e kërkuar nga kreu XIII i ligjit dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim për ankimet tatimore.”

22. Pika 106.1.8, paragrafi i parë, fjalia e parë ndryshon në përmbajtje si vijon:

“Me përjashtim të ankimimit të ushtruar nga tatimpaguesi, në përputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI të ligjit, masat administrative të parashikuara sipas këtij kreu dhe në kapituj të tjerë të këtij ligji, që kanë të bëjnë me masat e mbledhjes me forcë, nuk janë objekt apelimi administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor.”

23. Në pikën 107, fjala “interesa” zëvendësohet me fjalën “kamatëvonesa”.

24. Pika 107.1 ndryshohet në përmbajtje si vijon:

“107.1 Kur një detyrim tatimor është objekt ankimi, ankimi pranohet vetëm në qoftë se ankimuesi, në përputhje me nenin 107 (1) të ligjit:

a) paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor, objekt ankimi, të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet ose vendos garanci bankare për këtë shumë;

b) vërteton pagesën ose garancinë, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi ose të garancisë bankare. Si vërtetimi i pagesës, dhe ai i garancisë, janë kërkesa të detyrueshme.”

25. Pika 107.2.1 ndryshohet në përmbajtje si vijon:

“107.2.1 Shuma e pagueshme ose suma e vënë si garanci bankare, në përputhje me pikën 1 të nenit 107 të ligjit, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.”

26. Pika 107.3.1 ndryshohet në përmbajtje si vijon:

“107.3.1 Në qoftë se tatimpaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ose nuk vendos garancinë bankare, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet. Pra, nëse tatimpaguesi ka paraqitur ankimin, dhe pas këtij momenti, por para skadimit të afatit të apelimit, ka paguar tatimin dhe kamatëvonesat përkatëse ose ka vendosur garancinë bankare, Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT) duhet ta shqyrtojë ankimin. Drejtoria e Apelimit Tatimor nuk është e detyruar që para refuzimit të apelimit, ta informojë tatimpaguesin që ankimi i tij është i papranueshëm.”

27. Në fund të paragrafit 109.1 shtohet fjalia:

“Drejtoria e Apelimit Tatimor merr masat për publikimin e qëndrimeve të mbajtura në vendimet e marra prej saj në *website*-in e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”

28. Në fund të pikës 110.1 shtohet paragrafi me përmbajtje:

“Nëse tatimpaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të Drejtorisë së Apelimit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë apo vlerësohet të jetë marrë vendimi.”

29. Pika 114.3 e udhëzimit shfuqizohet.

30. Pika 117 ndryshon si më poshtë:

“117. Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në buxhetin e shtetit, tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhur apo të shmangur.”

31. Pika 120 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“120. Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 150.000 lekë.

Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150 000 lekë, dënohen me gjobë në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion.

Ky dënim do të zbatohet si për blerësin, edhe për shitësin, nëse të dy janë persona juridikë dhe/ose fizikë tregtarë, dhe blerësi ka paguar direkt shitësin me para në dorë. Në rast se blerësi ka paguar me para në dorë në llogarinë bankare të shitësit, dënimi zbatohet vetëm ndaj blerësit. Ashtu sikurse, nëse shitësi i autorizuar nga blerësi, për likuidimin e transaksionit ka tërhequr me para në dorë nga llogaria bankare e blerësit, dënimi zbatohet ndaj shitësit.”

32. Në pikën 127.2 të udhëzimit, hiqet fjalia e dytë e paragrafit me përmbajtjen:

“Për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël, kjo e drejtë i takon titullarit të zyrës së tatim-taksave të qeverisjes vendore”.

Ky udhëzim hyn fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani



VENDIM
Nr. 1, datë 17.1.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“AYEN ENERGY TRADING” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4, dhe 48, pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 8; 10, pika 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008; nenit 18, pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.1.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuar nga ERE-ja në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht;
- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 2, datë 17.1.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “g”; 8 dhe 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008; nenit 18, pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të

ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.1.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 3, datë 17.1.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EN. ERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 8; 9; 13 dhe 14, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.1.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EN. Ergy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EN. Ergy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;



- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EN. Ergy” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 4, datë 17.1.2014

**MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 17, SERIA PV04P TË SHOQËRISË
“MARJAKAJ” SHPK “PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” NGA HEC
“BENE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR. 43, DATË 14.10.2004**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “a”; 9; 13 pika 1, germa “a”; 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 13; 14, pika 2; 15, pikat 1, 2/b, 3, 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008; pikave 2.3 dhe 2.4 të “Licencës së prodhimit të energjisë elektrike”; Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.1.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. për modifikimin e licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC “Bene” me nr. 17, seria PV04P, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr 43, datë 14.10.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore, siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës;

- neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. me nr. 17, seria PV04P “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC “Bene” me fuqi 125 KW, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 43, datë 14.10.2004.

2. Fuqia e instaluar e HEC “Bene”, nga 125 KW të bëhet 1000 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 5, datë 17.1.2014

**MBI ANKANDIN E MUAJIT SHKURT 2014 TË KAPACITETEVE
TË INTERKONJEKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X, pika 2 të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE-ja me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2014, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike,

VENDOSI:

1. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë shoqërisë KESH sh.a., kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin shkurt 2014, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike, për furnizimin e konsumatorëve tariforë, duke pasur parasysh nevojën për kapacitet importues të pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.
2. OST sh.a. të zhvillojë ankand për muajin shkurt 2014, për kapacitetet e mbetura ndërkufitare në drejtimin e importit, me qëllim plotësimin e nevojave për kapacitet importues të pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.
3. OST sh.a. të zhvillojë ankandin për muajin shkurt 2014, për kapacitetet ndërkufitare me drejtim eksporti.
4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 48 lekë